



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Borezuar Punëdhënësi / Prilato Accepted / Delivered	19.01	2	with grid sheet
Organ / Organizata Org / Unit	Nr. Prot Pr. No	Shtesa Prot. / Appendix	Sasia Kopimeve Quantity
SKIKVSHCK	244/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1003/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1003/2021 të datës 06.12.2021 e parashtruar nga ankuesi me adresë Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 19.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.1003/2021 e datës 06.12.2021 e parashtruar nga ankuesi nga Prishtina.

A r s y e t i m

Ankuesi Inspektor i Ndërtimit në Komunën e Prishtinës, me datë 06.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5809/2021 të regjistruar me numër A.nr.1003/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me kërkesë që të detyrohet Komuna e Prishtinës për korrigjimin e arsyetimit të Vendimit me numër 14-112/01-229786/21 të datës 27.10.2021 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.12.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Prishtinës. Këshilli më datë 24.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/4.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 06.12.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin



Civil të Kosovës; Aktgjykimin me numër APS.nr.4/2021 të datës 26.04.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti Special; Vendimi me numër 14-112/01-229786/21 i datës 27.10.2021 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt emërimi i ankuesit i datës 01.11.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/4.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është *e pa lejuar sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke iu referuar shkresave të lëndës, gjegjësisht ankesës A.nr.1003/2021 të datës 06.12.2021 ka gjetur se ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se organi i punësimit me rastin e nxjerrjes se Vendimit me numër 14-112/01-229786/21 të datës 27.10.2021 gabimisht ka konstatuar paragrafin katër të arsyetimit të këtij vendimi ku thuhet se: *"...por me pëlqimin e të akuzuarit në fjalë është paguar dënimi me gjobë"* sepse sipas ankuesit i njëjti nuk është dënuar me gjobë dhe në asnjë formë tjetër, por është liruar nga aktakuza sipas vendimit të formës së prerë APS.nr.4/2021 dt.26.04.2021 të gjykatës së Apelit", dhe kërkon nga Këshilli që ta detyroj Komunën e Prishtinës respektivisht Sektorin e Burimeve Njerëzore që të bëjë korrigjimin e arsyetimit të vendimit të lartcekur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se ankuesi të vetmin pretendim ankimor e ka *"korrigjimin"* e një paragrafi të arsyetimit të Vendimit me numër 14-112/01-229786/21 të datës 27.10.2021, konstaton se ankesa A.nr.1003/2021 e datës 06.12.2021 është e palejuar sepse ankuesi para parashtrimit të ankesës në Këshill, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të organi i punësimit, rrjedhimit para parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi nuk ka parashtruar kërkesë për korrigjim të gabimit të pretenduara në organin e punësimit respektivisht në Komunën e Prishtinës, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 50 paragrafit 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *"1. Organi publik, në çdo kohë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës, mund të korrigjojë gabimet drejtshkrimore, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme, të dukshme, në një akt administrativ"* dhe 2. *Organi publik, ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet si dhe të çdo kopje të njësuar të tij"*. Andaj Kolegji konstaton se ankesa e datës 06.12.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar pa u shteruar mjetet e brendshme ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenit 16 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe"*.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1003/2021

Valentina Kaçandolli

Procesmbajtëse

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.